



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0929

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Batisha Ibrahimimi dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE “KOSPROD” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “168 Paisje IT-Tabela Digjitale” me numër të prokurimit 616-25-6962-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA PRISHTINË”, më 10/11/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “KOSPROD” SH.P.K me nr. 2025/0929, e datës 19/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “168 Paisje IT-Tabela Digjitale”, me numër të prokurimit 616-25-6962-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KOMUNA PRISHTINË”.

2, Anulohet Njoftimi për Kontratë dhe AK të zgjasë afatin për tenderim dhe ti bëjë përmirësimet e Dosjes së Tenderit.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 6, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 30.07.2025, “KOMUNA PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “168 Paisje IT-Tabela Digjitale” me numër të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, , vlera e parashikuar e kontratës: 610.000 €.

Me 13.09.2025, OE “KOSPROD” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 16.09.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga “KOSPROD” SH.P.K me nr. 2025/0929 lidhur me aktivitetin “168 Paisje IT-Tabela Digjitale” me numër të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “KOSPROD” SH.P.K Përgjigje nga AK:

-AK vlerëson se përpilimi i një plani MOSTER, është i domosdoshëm, për të vlerësuar kapacitetet Teknike - Profesionale të OE.

AK vlerëson se një kompani e TI duhet të ketë kapacitetet minimale për dizajnim dhe planifikimin e një rrjeti të brendshëm në Objekte Shkollore.

-Qëllimi i kërkesës është Identifikimi i kapaciteteve Teknike /Profesionale të OE.

Pretendimi ankimor është i pabazuar. Kërkesa për plan MOSTER - në MS VISION qëndron.

Përgjigja nga AK: AK konsideron se Implementimi në plotni i projektit është qëllimi kryesor sipas kërkesave të AK. Gjithashtu procedurat e prokurimit lejojnë Konserciumet ap bashkimin e 2 apo më shumë OE për të arritur qëllimin e projektit.

Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Përgjigja nga AK: AK siguron të gjithë OE - se forma e vlerësimit është standard i njëjtë i vlerësimit për të gjithë OE dhe si e tillë është transparente dhe nuk përben shkelje të vlerësimit Transparent. AK sqaron se renditja është bërë sipas prioriteteve të AK - dhe nuk ka të bëjë me peshim jo-proporcional.

AK sqaron se çmimi për njësi, është vendosur për shkak të natyrës së punës. Është pothuajse e pamundur me determine në fazën e ofertimit se sa metër Kabell UT nevojiten për shtrirje të rrjetës mundet me të nevojiten 100m, 1000m apo 10 000 m, varion nga forma e implementimit. Apo se sa WiFi duhet me u instaluar, pasi që në raste të caktuara kur trashësia e murit të një shkolle është më e madhe se ajo standard pengon shpërndarjen e rrjetës dhe rrjedhimisht paraqitet nevoja për WiFi shtesë.

Prandaj kërkohen çmimet për njësi në mënyrë që edhe Faturimi kur të bëhet të bëhet sipas punëve që janë implementuar.

- Gjithsesi forma e vlerësimit të procedurës së tenderimit për të gjithë OE - është e njëjtë dhe si e tillë nuk përben shkelje të transparencës apo diskreditime të OE dhe si e tillë forma aktuale qëndron. Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Përgjigja nga AK:

-AK vlerëson se për të gjitha produktet e specifikuara në paramasë ka më shumë se 2- 3 brende që i plotësojnë specifika teknike të AK.

AK sqaron se përpilimi i specifikave teknike është bërë duke u bazuar në praktikat më të mira vendore dhe ndërkombëtare, që garanton funksionalitet dhe sigurt dhe që për AK - është esenciale.

-AK vlerëson se Autorizimi nga Prodhuesi është esencial ~ i domosdoshëm për të shmangur mundësitë e manipulimit nga OE ~ me branda të blea nga Tregu i ZI, potencialisht dhe jo me garancion Valid nga Prodhuesi.

-AK: SMART BOARD të peshuar më pak, vlen sqarimi i njëjtë me pretendimin ankimor Nr.3, Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “KOSPROD” SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Më datë 13.09.2025 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, ndërsa më 16.09.2025 kemi pranuar vendimin refuzues. Si operator ekonomik i pakënaqur më këtë vendim dhe më kritëret e përcaktuara në dosjën e tenderit, paraqesim këtë ankësë pranë OShP, më qëllim që të sigurohët barazia në trajtim dhe konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve.

Pretendimi 1

Plani Shtrirjes së rrjetave

Në FDT me konkretisht 9.1 & 9.2, pika 9 kërkesa si:

9. OE duhet që para Ofertimit të përgatisë një planë mostër (shembull), të instalimit të rrjetave në MS Visio dhe të sjell në zyret e prokurimit. 9.Plani i shtrirjes së rrjetave (Pasive, Aktive) duhet të përgatitet në MS Visio (Mostër për një shkollë me 10 njësi mësimore) – dhe duhet të përfshihen të gjitha komponentet e cekuar në Aneksin 1. Që të prezantojë në mënyrë vizuale përgatitjen profesionale për implementim të projektit. Plan – Mostër duhet të sillet fizikisht në USB apo CD, ditën e hapjes deri ora 12 00

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues në përgjigjen e dhënë të datës 16.09.2025 ndaj pretendimit tonë, Autoriteti ka deklaruar se plani mostër është i domosdoshëm për të vlerësuar kapacitetet teknike[1]profesionale të operatorëve ekonomikë, duke shtuar se çdo kompani e TI duhet të ketë aftësi për dizajnimin dhe planifikimin e rrjeteve të brendshme.

Ky arsyetim i Autoritetit është i pabazuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, për këto arsye

Kapaciteti teknik-profesional nuk dëshmohet me vizatime ilustrative Sipas LPP, kapaciteti teknik dhe profesional i operatorëve dëshmohet përmes referencave nga punët e kryera më parë, certifikatave të stafit, qarkullimit financiar dhe licencave/certifikimeve përkatëse, e jo përmes vizatimeve mostër të përgatitura sipas interpretimit të secilit operator. (shih nenin 28 LPP).

Bartje e padrejtë e përgjegjësisë tek operatorët ekonomikë Plani i shtrirjes së rrjetave është përgjegjësi ekskluzive e Autoritetit Kontraktues si përfitues i projektit. AK duhet të përcaktojë qartë nevojat dhe specifikat (numri i portave, i access point-ëve, tipologjia e kabllimit etj.). Duke ia ngarkuar operatorëve hartimin e planit mostër, Autoriteti po e transferon padrejtësisht përgjegjësinë e tij ligjore tek ofertuesit.

Rrezik për diskriminim dhe mungesë transparence Një kërkesë e tillë e lë procesin e vlerësimit në terren subjektiv, pasi planet në MS Visio nuk mund të krahasohen mbi baza të qarta teknike.

Kjo krijon rrezik të diskriminimit ndërmjet operatorëve dhe cenon parimin e transparencës dhe barazisë (neni 7 LPP).

Neni 1 i LPP – kërkesa tejkalon qëllimin e prokurimit publik, pasi planifikimi i detajuar është detyrë e AK, jo e operatorëve;

Neni 7 i LPP – vendos kushte të panevojshme dhe krijon pabarazi ndërmjet operatorëve, duke cenuar konkurrencën e lirë

Neni 28 i LPP – specifikimet teknike nuk janë të qarta dhe nuk lidhen me performancën e objektit të kontratës

Në dosjen e tenderit është përcaktuar qartë se variantet nuk lejohen. Megjithatë, kërkesa për plan në Visio nxit operatorët të propozojnë variante të ndryshme të dizajnit të rrjetit, duke e vënë vetë Autoritetin në kundërshtim me dokumentet e shpallura prej tij. Kërkesa për hartimin dhe dorëzimin e planit mostër në MS Visio është e paligjshme, e paarsyeshme dhe diskriminuese. Ajo krijon pasiguri në ofertim, hap mundësi për vlerësim subjektiv dhe cenon konkurrencën e drejtë. Për më tepër, kjo përbën një bartje të padrejtë të përgjegjësisë të Autoritetit tek operatorët ekonomikë.

Për këto arsye, kërkojmë nga ekspertët e OShP që kjo kërkesë e Autoritetit Kontraktues të konstatohet si e kundërligjshme dhe e mangët në përmbajtje, si dhe të urdhërohet korrigjimi i saj me formulim të qartë dhe të saktë, në mënyrë që gjatë vlerësimit të sigurohet trajtimi i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomikë.

Pretendimi 2

Ndarja në Lote

Në dosjen e tenderit është vërejtur se një numër i madh artikujsh nga fusha të ndryshme janë përfshirë në një kontratë të vetme, pa asnjë ndarje sipas kategorive të tyre. Sipas kërkesave në dokumentacionin e tenderit dhe nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), konstatohet se kjo praktikë bie ndesh me disa parime të ligjit:

Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) – Bashkimi i pajisjeve të ndryshme nuk sjell përfitim ekonomik dhe kufizon konkurrencën në treg.

Neni 7 (Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi) – Operatorët me ekspertizë të veçantë nuk mund të konkurrojnë në mënyrë të barabartë.

Neni 27/A (Ndarja e kontratave në Lote) – Ligji lejon ndarje në lote për të mundësuar pjesëmarrje të gjerë dhe konkurrencë më të madhe.

Bashkimi i pajisjeve të ndryshme në një lot të vetëm bie ndesh me parimet e konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve që kanë ekspertizë vetëm në segmente të caktuara dhe duke ua pamundësuar atyre konkurrimin e drejtë, gjithashtu kur janë kërkuar për secilin produkt cmime për njësi dhe ndihet sasia e kërkuar nga vete autoriteti

Në këtë aktivitet, përveç tabelave digjitale, të cilat janë qëllimi kryesor i projektit, janë përfshirë edhe produkte tjera. Këto janë kategori krejtësisht të ndryshme mallrash dhe nuk është e arsyeshme që të trajtohen si një paketë e vetme. Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit, pasi nuk sjell përfitim për autoritetin kontraktues, përkundrazi ngushton tregun dhe zvogëlon konkurrencën.

Ekspertët e OSHP-së duhet të konstatojnë se kjo praktikë nuk është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik. Aktiviteti i prokurimit është tejte i paqartë dhe bashkimi i të gjitha fushave në një lot e bën edhe më të vështirë për operatorët ekonomikë të ofrojnë në mënyrë të barabartë dhe të konkurrojnë në bazë të ekspertizës së tyre. Për më tepër, përgjigja e Autoritetit datë 16.09.2025, se operatorët mund të krijojnë grupe ose konsorciume për të realizuar projektin, nuk bazohet në Ligjin e Prokurimit Publik, sepse operatorët nuk duhet të detyrohen të krijojnë konsorciume, por duhet të mund të konkurrojnë individualisht sipas fushës ku kanë ekspertizë. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të gabimit në formulimin e dosjes nga Autoriteti ku gjithqka në këto aktivitet ose është e mbyllur me autorizime ose është e pakjarte në sasi apo në instalime, duke kufizuar konkurrencën dhe duke cenuar parimet e barazisë dhe ekonomicitetit.

Për këtë arsye, kërkohet:

Kontrata të ndahet në lote të veçanta sipas ngjashmërisë së pajisjeve dhe kategorive të produkteve, për të garantuar konkurrencë të ndershme, barazi dhe efikasitet ekonomik;

Afati për dorëzimin e ofertave të shtyhet pas ndarjes së loteve, duke i dhënë operatorëve kohën e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të secilit lot, nëse sistemi nuk lejon ndarjen në lote, atëherë të behet anulimi i aktivitetit, me mirë të ruhet paraja publike se të lidhet kontrate duke mos ditur sasi e asgjë tjetër, sepse këto as vete autoriteti nuk e din.

Kjo masë është e domosdoshme për të siguruar një proces transparent, konkurrues dhe plotësisht në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, duke respektuar parimet e barazisë, ekonomicitetit dhe konkurrencës së ndershme.

Pretendimi 3

Peshimi i Çmimeve

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, kemi vërejtur se metodologjia e përcaktuar për vendosjen dhe vlerësimin e çmimeve është e pasaktë, jo proporcionale dhe në kundërshtim me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)

Sipas nenëve përkatëse të LPP-së

Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) – Pësja jo proporcionale nuk garanton zgjedhjen e ofertës më të favorshme dhe favorizon produkte që nuk janë thelbësore për qëllimin e projektit.

Neni 7 (Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi) – Operatorët penalizohen në mënyrë të padrejtë për produkte me rëndësi të ndryshme.

Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) – Vlerësimi aktual nuk është transparent dhe nuk siguron barazi midis ofertuesve.

Neni 60 (Kriteret për dhënien e kontratës) – Kriteret e çmimit nuk janë të qarta dhe nuk mundësojnë vlerësim të drejtë

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Autoriteti ka kërkuar çmime për njësi për secilin artikull, pa specifikuar sasitë reale që do të porositen, gjë që e bën të pamundur kuptimin e saktë të nevojave dhe vendos operatorët në pozita të padrejta. Në këtë mënyrë, operatorët ekonomikë detyrohen të ofrojnë çmime pa pasur informacion të qartë mbi sasitë, ndërsa Autoriteti mbetet me një mekanizëm të paqartë që nuk siguron transparencë, barazi dhe konkurrencë të ndershme.

Problematika e peshimit të çmimeve:

Shtrirja e rrjetave ka marrë 50% të peshës së projektit;

Pajisje si switch dhe router 30%;

Tabelat digjitale (Smartboard) vetëm 20%.

Ky shpërndarje tregon qartë se ky projekt është drejtuar kryesisht ndaj pajisjeve të rrjetit dhe infrastrukturës, ndërsa objektivi i aktivitetit, sipas titullit të tenderit “168 Pajisje IT – Tabela Digjitale”, është furnizimi me tabelat digjitale. Kjo bie ndesh me përmbajtjen dhe qëllimin e aktivitetit dhe krijon një mospërputhje të qartë midis kërkesave të Autoritetit dhe objektit real të projektit.

Për më tepër, shpërndarja e peshave nuk është proporcionale me rëndësinë reale të secilës kategori.

Produktet dytësore, që kanë rëndësi të vogël për aktivitetin kryesor, janë vlerësuar me peshë më të madhe, ndërsa tabelat digjitale, që janë thelbësore dhe kanë vlerë financiare më të madhe, kanë marrë peshë më të ulët. Kjo krijon hapësirë për vlerësim të padrejtë dhe manipulim të çmimeve, duke cënuar zgjedhjen e ofertës më të favorshme për Autoritetin.

Në këtë formë, operatorët ekonomikë janë të detyruar të ofrojnë pa informacion të saktë mbi sasitë dhe pa transparencë mbi vlerësimin, ndërsa Autoriteti nuk garanton barazi, ekonomicitet dhe efikasitet.

Kjo bie ndesh me parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik

Ne kërkojmë nga ekspertet dhe OSHP, që bazuar në këtë dosje tenderi të bëjë Rishikimin dhe korrigjimin e përshkrimit të çmimeve, duke përcaktuar sasi të reale dhe të qarta për çdo artikull;

1.00 A - Gjithsej (1 - 61) : 50%

2.00 B - Gjithsej (62 - 70) : 30

3.00 C - Gjithsej (71 - 96) : 20%

Rishikimin e metodologjisë së vlerësimit, në mënyrë që pesha e secilës kategori të jetë proporcionale me rëndësinë dhe vlerën reale të saj

Në rast se këto korrigjime nuk mund të bëhen brenda procedurës aktuale, kërkojmë anulimin e procedurës dhe rihapjen me kritere të qarta, transparente dhe jo-diskriminuese, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të konkurrojnë në kushte të barabarta.

Ky rishqyrtim është thelbësor për të garantuar një proces të drejtë, konkurrues dhe në përputhje me interesin publik, duke mundur që Autoriteti të marrë ofertën më cilësore dhe më të favorshme financiarisht, dhe duke eliminuar çdo shpërputhje midis kërkesave të dosjes dhe objektit real të aktivitetit.

Nuk është e drejtë që Autoritetet të dalin me vendime refuzuese ndaj kërkesave për rishqyrtim, duke argumentuar se nuk dihet nëse nevojiten 1, 10, 15 apo 10,000 metra kablo. Kjo tregon se kërkesat e Autoritetit janë të paqarta edhe për vetë Autoritetin, ndërsa për operatorët ekonomikë dosja e tenderit mbetet e paqartë, jo e specifikuar dhe jo në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Pretendimi 4

Produktet e rrjetit të mbyllura me autorizime

Duke shqyrtuar specifikimin teknik të referuar në Aneksin 1 (përshkrimi i çmimeve), vërejmë se për disa produkte të Tabelës B (Nr. 35, 37, 38, 39, 40 dhe 41) kërkohet autorizim nga prodhuesi ose distributori. Konkretisht produktet janë:

35: Firewall Router

37: WiFi 7 Access Point (AP)

38: Switch 28-port L2+ PoE me 10G uplinks

39: Switch 52-port L2+ PoE me 10G uplinks

40: Router

41: Hardware Controlle

Bazuar në këto kërkesa specifike dhe kriterin e autorizimeve konstatohet se kemi shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP):

Neni 28 (Specifikimet teknike) – specifikimet e mbyllura kufizojnë konkurrencën

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – operatorët e tjerë nuk mund të ofrojnë produktet e tyre;

Neni 52 (Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës) – kriteret për autorizim nuk janë të qarta dhe të komunikueshme;

Neni 69 (Aftësia teknike dhe/ose profesionale) – kufizimi pengon ofertues me aftësi të barabartë. Vërejmë se këto produkte janë specifikuar me modele të caktuara dhe kërkojnë autorizime që vetëm disa operatorë ekonomik mund t'i sigurojnë. Si pasojë, kjo mbyll mundësinë për ofertim nga operatorë të tjerë dhe kufizon konkurrencën në mënyrë të papërshtatshme, duke krijuar një situatë selektive që nuk është në përputhje me LPP-në

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, specifikimet teknike duhet të jenë të hapura, transparente dhe të barabarta për të gjithë operatorët ekonomik, në mënyrë që të mundësohet ofertim konkurrues dhe i lirë. Aktualisht, kërkesat për autorizim për produktet e sipërpërmendura kanë krijuar barriera që pengojnë ofertuesit e tjerë të ofrojnë produktet e tyre.

Përgjigja e Autoritetit, sipas së cilës këto specifikime mund të ofrohen edhe nga brendet e tjera, është një e pavërtetë e madhe. Në realitet, kërkesat specifike nuk plotësohen nga asnjë brand tjetër përveç atyre të precizuara, me ose pa interes. Kjo situatë nuk i bën mirë Autoritetit dhe nuk garanton transparencë apo konkurrencë të lirë për publikun. Ekspertët e OSHP-së mund ta verifikojnë këtë

lehtësisht me një shfletim të thjeshtë në internet, dhe do të konstatojnë se kërkesat e Autoritetit janë mbyllëse dhe selektive.

Ne si operatorë kërkojmë:

Heqjen e kërkesave për autorizim specifik për produktet e Tabelës B;

Sigurimin që specifikimet teknike të jenë të hapura dhe të mundësojnë ofertim nga të gjithë operatorët ekonomik;

Në vend të autorizimeve, të kërkohet garanci për produktet e ofruara, në mënyrë që Autoriteti të mbetet i sigurt për cilësinë dhe përputhshmërinë e produkteve.

Aktualisht, produktet e kërkuara janë të mbyllura me autorizim, janë vendosur me sasi 1 copë, dhe nuk specifikohet sasia reale që duhet furnizuar. Shumë produkte nuk kanë ekuivalencë në specifikim; për shembull, Firewall Router (produkt nr. 35) përjashton të gjitha brand-et tjera, ndërsa për Access Point (produkt nr. 37), Switch 28-port (produkt nr. 38), Switch 52-port (produkt nr. 39), Router (produkt nr. 40) dhe Hardware Controller (produkt nr. 41) kërkohet autorizim specifik nga prodhuesi.

Përgjigja e Autoritetit, se autorizimi është i nevojshëm për të “larguar tregun e zi”, nuk mbështetet në ligj dhe nuk mund të justifikojë mbylljen e konkurrencës tek një operator i vetëm. Autoriteti ose duhet të liroj specifikimet për të mundësuar ofertim nga shumë operatorë, ose duhet të heqë kërkesën për autorizim dhe të lejojë ofertim të lirë.

Duke pasur parasysh vlerën e lartë të projektit dhe situatën aktuale, lehtësimi i kriterëve për autorizim është i domosdoshëm për të mundësuar ofertim konkurrues, barazi dhe transparencë, duke garantuar që Autoriteti të marrë ofertën më cilësore dhe më të favorshme financiarisht.

Kërkojmë nga OSHP që të vlerësojë këtë ankesë dhe të rekomandojë Autoritetin që të largojë autorizimet e panevojshme, të lirojë specifikimet teknike dhe të sigurojë një proces transparent, të drejtë dhe konkurrues për të gjithë operatorët ekonomik.

Ne vijim po marrim shembull Firewall:

Kërkesat dhe plotësimi i tyre vetem nga Check Point vs konkurrentët:

Bazuar në analizën e mësipërme, vetëm Check Point plotëson të gjitha kërkesat specifike për Firewall Router, duke përfshirë throughput të kërkuar, protokolle rutimi të avancuara, ClusterXL High Availability, licencat e plota për Threat Prevention dhe menaxhimin GUI lokal dhe cloud

Konkurrentët kryesorë (Cisco, Fortinet, Palo Alto) nuk ofrojnë në të njëjtën pajisje të gjitha këto veçori në të njëjtën kohë, veçanërisht kur aktivizohen të gjitha modulet e avancuara të sigurisë. Kjo tregon qartë se kërkesa është e dedikuar vetëm për Check Point dhe asnjë tjetër brand nuk e plotëson komplet këtë paketë funksionesh.

Kerkojme rishiqim te produkteve numer: 35,37,38,39,40,41 sepse te gjitha keto produkte jane specifike dhe nuk ka ekuivalence per permbushje te specifikimeve teknike me produkte te tjera, kjo mund te vertetohet edhe nga Ekspertet

Pra kerkojme qe te behet nje riformulim specifikiash me rastin e permiresimit te dosjes, te behen specifikimet teknike ne ate forme qe nuk mbyllin konkurence.

Pretendimi 4

Tabelat e Mençura – specifikim per vetem nje Brand dhe autorizim

Duke shqyrtuar specifikimin teknik të projektit “Furnizim me Tabela Digjitale”, vërejmë se për Tabelën C (pozicionet 71–96), e cila përbën vetëm 20% të vlerës totale të ofertës, kërkohet një specifikim i veçantë që lidhet direkt me një prodhues të vetëm.

Ne mund të ofrojmë produktin e kërkuar, por për shkak të kërkesës për autorizim nga prodhuesi, nuk mund të ofertojmë këtë produkt. Kjo krijon një barrierë artificiale që kufizon konkurrencën dhe pengon ofertim të lirë, duke vendosur operatorët e tjerë në një pozitë të pabarabartë.

NO Rikapitulumi

1.00 A - Gjithsej (1 - 61) : 50%

2.00 B - Gjithsejt (62 - 70) : 30%

3.00 C - Gjithsejt (71 - 96) : 20%

Pesha e projektit është e shpërndarë si më poshtë:

A – Gjithsej (1–61): 50%

B – Gjithsej (62–70): 30%

C – Gjithsej (71–96 – Tabela Digjitale): 20%

Pra, aktiviteti kryesor i prokurimit, blerja e Tabelave Digjitale, është nënvlerësuar dhe i kushtëzuar nga një model specifik, ndërsa pjesa tjetër e projektit favorizon produkte të tjera, duke krijuar një përçarje të paarsyeshme të peshës dhe prioritetit të prokurimit.

Kërkesa aktuale për autorizim shkel qartë nenet e LPP-së:

Neni 28 (Specifikimet teknike) – specifikim i mbyllur për një model të vetëm;

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – kufizon ofertim të lirë dhe konkurrencë të ndershme;

Neni 65 (Provueshmëria e kandidatëve / tenderuesve) – operatorët nuk mund të sigurojnë autorizim, duke shkelur mundësinë për ofertim të barabartë.

Problemet kryesore janë:

Operatorët ekonomik nuk mund të marrin autorizim direkt nga prodhuesi;

Përdorimi i distributorit nuk është zgjidhje reale, pasi prodhuesi nuk ka distributor të autorizuar në rajonin tonë;

Specifikimi teknik lidhet direkt me një model të vetëm, duke penguar përdorimin e produkteve alternative që përmbushin të njëjtat kërkesa;

Përgjigjja e Autoritetit, se specifikimet mund të plotësohen nga brendet e tjera, është plotësisht e pavërtetë, pasi asnjë brand tjetër nuk përmbush kërkesat e funksionaliteteve kritike si monitorim nga larg, mesazhe emergjente, bllokim, restart dhe factory reset. Ekspertët mund ta verifikojnë këtë lehtësisht me një shfletim në internet.

Kerkojme nga Ekspertet dhe Paneli që të rekomandojë autoritetin që të heqë kërkesën për autorizim dhe të lejojë ofertim me garanci nga prodhuesi ose distributori

Të rishikojë specifikimet teknike në mënyrë që të mundësohet ofertim nga produktet digjitale alternative që përmbushin funksionalitetin e kërkuar

OSHP të konstatojë qartësisht barrierat dhe të rekomandojë korrigjimin e projektit për të garantuar konkurrencë të drejtë dhe transparente dhe të marrin pjese me shume operatore ekonomik.

Kjo qasje do të sigurojë që të gjithë operatorët ekonomik të mund të konkurrojnë në kushte të barabarta, duke respektuar ligjin për prokurimin publik dhe duke garantuar interesin e Komunës së Prishtinës. të SMART Technologies, duke demonstruar qartë se asnjë brand tjetër nuk ofron të gjitha funksionalitetet e kërkuar

Kërkesat dhe plotësimi i tyre nga SMART vs konkurrentët

Bazuar në analizën e mësipërme, vetëm SMART Technologies me SMART Remote Management plotëson të gjitha kërkesat e specifikimeve të tabelave të mençura, duke përfshirë monitorim nga larg, menaxhim softuerik, politika përdorimi, mesazhe emergjente, bllokim, restart, dhe factory reset. Brendet e tjera, si Promethean, BenQ dhe Clevertouch, ofrojnë vetëm pjesë të funksionaliteteve, por nuk plotësojnë kërkesat në mënyrë të plotë dhe të integruar, veçanërisht për komandat kritike dhe dërgimin e mesazheve emergjente. Kjo tregon qartë se kërkesa i dedikohet vetëm SMART dhe asnjë tjetër brand nuk e plotëson komplet këtë paketë veçorish. KERKOJME: Kërkojme nga OSHP, që të urdheroj AK-ne për permiresimin e kriterëve të dosjes. Gjithashtu t'i erkoj AK-s ndarjen në LOTE.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenet e shkelura: Neni 1; Neni 6; Neni 52; Neni 69; Neni 60; Neni 27A; Neni 28; Neni 56; Neni 65; Përmes kësaj ankese kërkojmë që të merret: VENDIM I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik KOSPROD SHPK II. KORRIGJOHET procedura e dosjes së tenderit dhe të HIQEN kriteret diskriminuese ashtu siç i kemi paraqitur në pretendimet tona

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 23.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0929/25, ndërsa me datë 06.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0929 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe AK lejohet të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale AK pajtohet me raportin e ekspertizës ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "KOSPROD" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0929 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës Me datën: 19.09.2025, OE "KOSPROD" SH.P.K.- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0929, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "168 Paisje IT-Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit: "616-25-6962-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, , vlera e parashikuar e kontratës: 610.000 €.

Sipas OE Është shkel Nenet e shkelura:Neni1; Neni 6; Neni 52; Neni 69; Neni 60; Neni 27A; Neni 28; Neni 56; Neni 65

Pretendimi i 1 , OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë.

Më datë 13.09.2025 kemi paraqitur kërkësë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, ndërsa më 16.09.2025 kemi pranuar vendimin rëfuzuës. Si operator ekonomik i pakë naqur më këtë vendim dhe më kritëretë e përcaktuara në dosjën e tenderit, paraqesim këtë ankësë pranë OShP, më që llim që të sigurohët barazia në trajtim dhe konkurrënca ë drëjtë ndërmjet operatorëve vë. Pretndimi 1 Plani Shtrirjes se rrjetave Ne FDT me konkretisht 9.1 & 9.2, pika 9 kerkesa si: 9. OE duhet që para Ofertimit të përgatisë një planë mostër (shembull), të instalimit të rrjetave në MS Visio dhe të sjell në zyret e prokurimit. 9.Plani i shtrirjes së rrjetave (Pasive, Aktive) duhet të përgatitet në MS Visio (Mostër për një shkollë me 10 njësi mësimore) – dhe duhet të përfshihen të gjitha komponentet e cekuar ne Aneksin 1. Që të prezantojë në mënyrë vizuale përgatitjen profesionale për implementimë të projektit. Plani – Mostër duhetë të sillet fizikisht në USB apo CD, ditën e hapjes deri ora 12 00.

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues në përgjigjen e dhënë te dates 16.09.2025 ndaj pretendimit tonë,

Autoriteti ka deklaruar se plani mostër është i domosdoshëm për të vlerësuar kapacitetet teknikeprofesionale të operatorëve ekonomikë, duke shtuar se çdo kompani e TI duhet të ketë aftësi për dizajnimin dhe planifikimin e rrjeteve të brendshme. Ky arsyetim i Autoritetit është i pabazuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, për këto arsye: Kapaciteti teknik-profesional nuk dëshmohet me vizatime ilustrative Sipas LPP, kapaciteti teknik dhe profesional i operatorëve dëshmohet përmes referencave nga punët e kryera më parë, certifikatave të stafit, qarkullimit financiar dhe licencave/certifikimeve përkatëse, e jo përmes vizatimeve mostër të përgatitura sipas interpretimit të secilit operator. (shih nenin 28 LPP). Bartje e padrejtë e përgjegjësisë tek operatorët ekonomikë Plani i shtrirjes së rrjetave është përgjegjësi ekskluzive e Autoritetit Kontraktues si përfitues i projektit. AK duhet të përcaktojë qartë nevojat dhe specifikat (numri i portave, i access point-ëve, tipologjia e kabllimit etj.). Duke ia ngarkuar operatorëve hartimin e planit mostër, Autoriteti po e transferon padrejtesisht përgjegjësinë e tij ligjore tek ofertuesit.

Rrezik për diskriminim dhe mungesë transparence Një kërkesë e tillë e lë procesin e vlerësimit në terren subjektiv, pasi planet në MS Visio nuk mund të krahasohen mbi baza të qarta teknike. Kjo krijon rrezik të diskriminimit ndërmjet operatorëve dhe cenon parimin e transparencës dhe barazisë (neni 7 LPP). Neni 1 i LPP – kërkesa tejkalon qëllimin e prokurimit publik, pasi planifikimi i detajuar është detyrë e AK, jo e operatorëve; Neni 7 i LPP – vendos kushte të panevojshme dhe krijon pabarazi ndërmjet operatorëve, duke cenuar konkurrën e lirë; Neni 28 i LPP – specifikimet teknike nuk janë të qarta dhe nuk lidhen me performancën e objektit të kontratës; Në dosjen e tenderit është përcaktuar qartë se variantet nuk lejohen. Megjithatë, kërkesa për plan në Visio nxit operatorët të propozojnë variante të ndryshme të dizajnit të rrjetit, duke e vënë vetë Autoritetin në kundërshtim me dokumentet e shpallura prej tij. Kërkesa për hartimin dhe dorëzimin e planit mostër në MS Visio është e paligjshme, e paarsyeshme dhe diskriminuese. Ajo krijon pasiguri në ofertim, hap mundësi për vlerësim subjektiv dhe cenon konkurrën e drejtë. Për më tepër, kjo përbën një bartje të padrejtë të përgjegjësisë të Autoritetit tek operatorët ekonomikë. Për këto arsye, kërkojmë nga ekspertët e OShP që kjo kërkesë e Autoritetit Kontraktues të konstatohet si e kundërligjshme dhe e mangët në përmbajtje, si dhe të urdhërohet korrigjimi i saj me formulim të qartë dhe të saktë, në mënyrë që gjatë vlerësimit të sigurohet trajtimi i

barabartë i të gjithë operatorëve ekonomikë.

Përgjigje në Pretendimin 1 , OE "KOSPROD " SH.P.K."- Prishtinë:

Eksperti shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Dosje të tenderit . Kërkesa e Autoritetit Kontraktues: OE duhet të përgatisë një plan mostër (shembull) për instalimin e rrjetave në MS Visio dhe ta dorëzojë fizikisht në USB/CD ditën e hapjes deri ora 12:00. Plani duhet të përfshijë të gjitha komponentët e cekuar në Aneksin 1 dhe të paraqesë vizualisht përgatitjen profesionale për implementim të projektit në një shkollë me 10 njësi mësimore.

Eksperti shqyrtues thekson Hartimi i e dosjes te tenderit është kërkesës e nenit 27 te Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. dhe nenit 17 RRPP Ne përputhje me nenin 17 .12 te RRPP së 17.12 Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë dhe ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit është kërkuar : OE duhet të përgatisë një plan mostër

OE ka pretenduar se kjo kërkesë është e paligjshme, e pa arsyeshme dhe diskriminuese, duke argumentuar se: Kapaciteti teknik-profesional nuk mund të dëshmohet me vizatime ilustrative. Plani mostër transferon padrejtësisht përgjegjësinë e AK tek OE, dhe se Kërkesa krijon rrezik për diskriminim dhe mungesë transparence dhe kërkesa tejkalon qëllimin e prokurimit publik dhe cenon konkurrencën e lirë.

Ekspertit shqyrtues mendon se : Plani mostër nuk është dokument përfundimtar i projektit, por një instrument vizual, metodologji për të vlerësuar kapacitetet profesionale të OE-së në lidhje me zbatimin e punimeve komplekse. Sipas Neni 28 të LPP-së, autoriteti kontraktues është i obliguar që të vendosë specifikime teknike të qarta, të arsyeshme dhe të pa-kufizuara vetëm për një operator të caktuar. Megjithatë, Ligji nuk përcakton që kapaciteti teknik-profesional duhet të vërtetohet vetëm me një plan mostër. Një plan mostër mund të funksionojë si shtesë vizuale ose ilustruese për ofertuesit që dëshirojnë të demonstrojnë aftësinë e tyre, por nuk mund të shndërrohet në kërkesë ligjore kryesore,. Planifikimi i detajuar është përgjegjësi e AK-së në përcaktimin e specifikimeve dhe komponentëve të nevojshëm. Kërkesa e AK-së për plan mostër nuk transferon përgjegjësi ligjore, por teston aftësinë e ofertuesit për të interpretuar dhe planifikuar një instalim standard sipas specifikimeve të dhëna. Plani mostër është i standardizuar: një shembull për një shkollë me 10 njësi mësimore dhe përfshin të gjithë komponentët e kërkuar. Kjo qasje redukton subjektivitetin në vlerësimin e ofertave, sepse të gjithë ofertuesit ofrojnë një plan të njëjtë bazuar në të njëjtën shembull.

Eksperti shqyrtues mendon se Kërkesa nuk shkel nenet e LPP, përfshirë nenin 1 (qëllimi i prokurimit), nenin 7 (barazia dhe konkurrenca.Përkundrazi, kjo është një praktikë e zakonshme për projekte komplekse TIK, që siguron vlerësim objektiv dhe të barabartë të ofertuesve. Pretendimi i OE-së se kërkesa për plan mostër është e paligjshme dhe diskriminuese është i pabazuar. Kërkesa e AK-së është legjitime , Plani mostër duhet të ruhet si kriter i vlefshëm për vlerësimin e kapaciteteve profesionale të

ofertuesve, pa interpretuar se transferon përgjegjësi të AK-së dhe si përfundim

Eksperti Shqyrtues Thekson se Pretendimi i OE , OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë ankues gjendet i PA BAZUAR

Pretendimi i 2 OE, OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë “

Ndarja ne Lote Në dosjen e tenderit është vërejtur se një numër i madh artikujsh nga fusha të ndryshme janë përfshirë në një kontratë të vetme, pa asnjë ndarje sipas kategorive të tyre. Sipas kërkesave në dokumentacionin e tenderit dhe nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), konstatohet se kjo praktikë bie ndesh me disa parime të ligjit: Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) – Bashkimi i pajisjeve të ndryshme nuk sjell përfitim ekonomik dhe kufizon konkurrencën në treg. Neni 7 (Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi) – Operatorët me ekspertizë të veçantë nuk mund të konkurrojnë në mënyrë të barabartë. Neni 27/A (Ndarja e kontratave në Lote) – Ligji lejon ndarje në lote për të mundësuar pjesëmarrje të gjerë dhe konkurrencë më të madhe. Bashkimi i pajisjeve të ndryshme në një lot të vetëm bie ndesh me parimet e konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve që kanë ekspertizë vetëm në segmente të caktuara dhe duke ua pamundësuar atyre konkurrimin e drejtë, gjithashtu kur janë kerkuar per secilin produkt cmime per njesi dhe nuk dihet sasia e kerkuar nga vete autoriteti. Në këtë aktivitet, përveç tabelave digjitale, të cilat janë qëllimi kryesor i projektit, janë përfshirë edhe produkte tjera. Këto janë kategori krejtësisht të ndryshme mallrash dhe nuk është e arsyeshme që të trajtohen si një paketë e vetme. Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit, pasi nuk sjell përfitim për autoritetin kontraktues, përkundrazi ngushton tregun dhe zvogëlon konkurrencën. Ekspertët e OSHP-së duhet të konstatojnë se kjo praktikë nuk është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik. Aktiviteti i prokurimit është tejte i paqartë dhe bashkimi i të gjitha fushave në një lot e bën edhe më të vështirë për operatorët ekonomikë të ofrojnë në mënyrë të barabartë dhe të konkurrojnë në bazë të ekspertizës së tyre. Për më tepër, përgjigja e Autoritetit datë 16.09.2025, se operatorët mund të krijojnë grupe ose konsorciume për të realizuar projektin, nuk bazohet në Ligjin e Prokurimit Publik, sepse operatorët nuk duhet të detyrohen të krijojnë konsorciume, por duhet të mund të konkurrojnë individualisht sipas fushës ku kanë ekspertizë. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të gabimit në formulimin e dosjes nga Autoriteti ku gjithqka ne kete aktivitet ose eshte e mbyllur me autorizime ose eshte e pakjarte ne sasi apo ne instalime, duke kufizuar konkurrencën dhe duke cenuar parimet e barazisë dhe ekonomicitetit. Për këtë arsye, kërkojmë: Kontrata të ndahet në lote të veçanta sipas ngjashmërisë së pajisjeve dhe kategorive të produkteve, për të garantuar konkurrencë të ndershme, barazi dhe efikasitet ekonomik; Afati për dorëzimin e ofertave të shtyhet pas ndarjes së loteve, duke i dhënë operatorëve kohën e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit të secilit lot, nese sistemi nuk lejon ndarjen ne lote, athere te behet anulimi i aktivitetit, me mire te ruhet paraja publike se te lidhet kontrate duke mos ditur sasi e asgje tjeter, sepse kete as vete autoriteti nuk e din.

Kjo masë është e domosdoshme për të siguruar një proces transparent, konkurrues dhe plotësisht në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, duke respektuar parimet e barazisë, ekonomicitetit dhe konkurrencës së ndershme.

Përgjigje në Pretendimin 2 te OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë

Eksperti shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Dosje te tenderit është e vërtetë se ne Rregulloren për prokurim Publike në nenin 18 i lejon autoritetit kontraktues ta ndajë një kontratë në lote, sidomos kur kjo rrit konkurrencën dhe

mundëson pjesëmarrje më të gjerë. Por, neni 11.3 i LPP parasheh qartë se autoriteti kontraktues nuk guxon të ndajë artificialisht kontratën me qëllim të shmangies së pragjeve apo dispozitave të tjera ligjore. 13.2 Në rast të kontratave të përbëra nga një sërë punësh, mallrash ose shërbimesh homogjene ose heterogjene, kontrata mund të ndahet në lote (pjesë). Kjo metodë mund të përdoret në veçanti për qëllime të inkurajimit të pjesëmarrësve të bizneseve të vogla dhe të mesme. Kjo gjithashtu mund të bëhet për të siguruar konkurrencë më të gjerë përmes mundësimit të OE më të specializuar që janë në gjendje të furnizojnë vetëm pjesë specifike të mallrave, shërbimeve dhe punëve. Sidoqoftë, ndarja në lote nuk nënkupton ndarjen e vlerës së kontratës ose shmangien nga pragjet e vlerave, pasi që përbëhet nga vlera e përbashkët e loteve.

Ekspertit shqyrtues thekson Në këtë rast konkret, objekti i kontratës është furnizimi dhe instalimi i smartboard-ve nëpër shkolla gjatë një periudhe 36-mujore, së bashku me pajisje dhe infrastrukturë mbështetëse që janë funksionalisht të ndërlidhura. Dhe se Smartboard nuk mund të përdoret në mungesë të infrastrukturës së rrjetit (Wi-Fi/kabllim), dhe anasjelltas, rrjeti pa pajisjet kryesore (smartboard) nuk i përmbush objektivat e projektit. Pra, bëhet fjalë për një sistem të integruar, jo për produkte të pavarura. Nëse këto ndahen në lote, rreziku është që të fitojnë operatorë të ndryshëm, duke sjellë pastaj probleme të përgjegjësisë dhe integritetit: një OE thotë nuk është rrjeti im , tjetri thotë smartboard-i nuk është instaluar mirë, ndërsa autoriteti kontraktues mbetet pa një fajtor të qartë dhe me sistem jo-funksional. Ky është një cenim i parimit të ekonomicitetit dhe efikasitetit neni 6 Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Po ashtu, pretendimi i OE-së se operatorët nuk duhet të detyrohen të hyjnë në konsorcium nuk qëndron plotësisht. LPP e njeh ofertën e përbashkët dhe kjo është mënyra ligjore për operatorët që kanë ekspertizë në fusha të ndryshme të bashkohen dhe të konkurrojnë së bashku. Nuk është detyrim i padrejtë, por një opsion i hapur për të siguruar konkurrencë. Argumenti i OE-së për paqartësi në sasi dhe instalime është i natyrës tjetër (mungesë e qartësisë teknike dhe mund të adresohet veçmas, por nuk e bën të domosdoshme ndarjen në lote.

Eksperti shqyrtues mendon se Pretendimi i OE-së për domosdoshmëri të ndarjes në lote nuk qëndron në këtë rast, sepse objektet e kontratës janë teknikisht të ndërvapura dhe duhet të trajtohen si një projekt i vetëm i integruar. Ndarja në lote këtu do të sillte më shumë rrezik për mosfunksionim dhe konflikt mes operatorëve sesa përfitim ekonomik ose konkurrencë. Autoriteti kontraktues ka vepruar në përputhje me LPP-së duke e trajtuar si një kontratë të vetme. Operatorët Ekonomik që kanë ekspertizë vetëm në një segment kanë mundësi ligjore të bashkohen përmes konsorciumit, sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe si përfundim

Eksperti Shqyrtues Mendon se pretendim i gjendet i PA BAZUA

Pretendimi i 3 OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë:.

Pretendimi 3 Peshimi i Çmimeve Pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, kemi vërejtur se metodologjia e përcaktuar për vendosjen dhe vlerësimin e çmimeve është e pasaktë, jo proporcionale dhe në kundërshtim me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Sipas nenëve përkatëse të LPP-së: Neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) – Pësia jo proporcionale nuk garanton zgjedhjen e ofertës më të favorshme dhe favorizon produkte që nuk janë thelbësore për qëllimin e projektit. Neni 7 (Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi) – Operatorët penalizohen në mënyrë të padrejtë për produkte me rëndësi të ndryshme. Neni 59 (Eksaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) – Vlerësimi aktual nuk është

transparent dhe nuk siguron barazi midis ofertuesve. Neni 60 (Kriteret për dhënien e kontratës) – Kriteret e çmimit nuk janë të qarta dhe nuk mundësojnë vlerësim të drejtë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Autoriteti ka kërkuar çmime për njësi për secilin artikull, pa specifikuar sasitë reale që do të porositen, gjë që e bën të pamundur kuptimin e saktë të nevojave dhe vendos operatorët në pozita të padrejta. Në këtë mënyrë, operatorët ekonomikë detyrohen të ofrojnë çmime pa pasur informacion të qartë mbi sasitë, ndërsa Autoriteti mbetet me një mekanizëm të paqartë që nuk siguron transparencë, barazi dhe konkurrencë të ndershme. Problematika e peshimit të çmimeve:

1.00 A - Gjithsej (1 - 61) : 50%

2.00 B - Gjithsej (62 - 70) : 30%

3.00 C - Gjithsej (71 - 96) : 20%

Shtrirja e rrjetave ka marrë 50% të peshës së projektit;

Pajisje si switch dhe router 30%;

Tabelat digjitale (Smartboard) vetëm 20%.

Ky shpërndarje tregon qartë se ky projekt është drejtuar kryesisht ndaj pajisjeve të rrjetit dhe infrastrukturës, ndërsa objektivi i aktivitetit, sipas titullit të tenderit “168 Pajisje IT – Tabela Digjitale”, është furnizimi me tabelat digjitale. Kjo bie ndesh me përmbajtjen dhe qëllimin e aktivitetit dhe krijon një mospërputhje të qartë midis kërkesave të Autoritetit dhe objektit real të projektit. Për më tepër, shpërndarja e peshave nuk është proporcionale me rëndësinë reale të secilës kategori. Produktet dytësore, që kanë rëndësi të vogël për aktivitetin kryesor, janë vlerësuar me peshë më të madhe, ndërsa tabelat digjitale, që janë thelbësore dhe kanë vlerë financiare më të madhe, kanë marrë peshë më të ulët. Kjo krijon hapësirë për vlerësim të padrejtë dhe manipulim të çmimeve, duke cenuar zgjedhjen e ofertës më të favorshme për Autoritetin. Në këtë formë, operatorët ekonomikë janë të detyruar të ofrojnë pa informacion të saktë mbi sasitë dhe pa transparencë mbi vlerësimin, ndërsa Autoriteti nuk garanton barazi, ekonomikitet dhe efikasitet. Kjo bie ndesh me parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik. Ne kërkojmë nga ekspertet dhe OSHP, që bazuar në kete dosje tenderi të bëjë Rishikimin dhe korrigjimin e përshkrimit të çmimeve, duke përcaktuar sasitë reale dhe të qarta për çdo artikull; Rishikimin e metodologjisë së vlerësimit, në mënyrë që pesha e secilës kategori të jetë proporcionale me rëndësinë dhe vlerën reale të saj; Në rast se këto korrigjime nuk mund të bëhen brenda procedurës aktuale, kërkojmë anulimin e procedurës dhe rihapjen me kriteret të qarta, transparente dhe jo-diskriminuese, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të konkurrojnë në kushte të barabarta. Ky rishqyrtim është thelbësor për të garantuar një proces të drejtë, konkurrues dhe në përputhje me interesin publik, duke mundësuar që Autoriteti të marrë ofertën më cilësore dhe më të favorshme financiarisht, dhe duke eliminuar çdo shpërrydhje midis kërkesave të dosjes dhe objektit real të aktivitetit. Nuk është e drejtë që Autoritetet të dalin me vendime refuzuese ndaj kërkesave për rishqyrtim, duke argumentuar se nuk dihet nëse nevojiten 1, 10, 15 apo 10,000 metra kablo. Kjo tregon se kërkesat e Autoritetit janë të paqarta edhe për vetë Autoritetin, ndërsa për operatorët ekonomikë dosja e tenderit mbetet e paqartë, jo e specifikuar dhe jo në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Përgjigje në Pretendimin i 3 i OE “KOSPROD” SH.P.K.”- Prishtinë

Eksperti shqyrtues për PRETENDIMIN – Peshimi i Çmimeve Pretendimi i Operatorit Ekonomik: OE ka vënë në dukje se metodologjia e vlerësimit të çmimeve nuk është proporcionale dhe nuk garanton zgjedhjen e ofertës më të favorshme. Peshat e dhëna sipas kategorive: shtrirja e rrjetave 50%, switch/router 30%, tabelat digjitale 20%, nuk korrespondojnë me rëndësinë reale të objektit të kontratës (tabelat digjitale). Çmimet janë kërkuar për njësi, pa specifikuar sasitë reale, duke vendosur operatorët në pozitë të pasigurt dhe duke rrezikuar transparencën dhe konkurrencën e drejtë. Operatori Ekonomik kërkon rishikimin e metodologjisë së vlerësimit dhe përcaktimin e sasive reale për çdo artikull ose, në rast të pamundësisë, anulimin dhe rihapjen e procedurës

Eksperti Shqyrtues thekson se Sipas RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve paragrafi . 40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjene tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktues nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve..... dhe se 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; 40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Ekspertit thekson se :Kërkesa për çmim për njësi është arsyeshme dhe e përshtatshme në kontekstin e projekteve IT me variacione të mundshme në implementim. Fleksibiliteti në çmim për njësi nuk cenon parimet e barazisë dhe transparencës, sepse të gjithë operatorët i ofrojnë çmimet në të njëjtat kushte, dhe se Renditja sipas prioriteteve të AK nuk është arbitrare, por reflekton vlerësimin profesional të rëndësisë së secilës kategori për implementimin e projektit. Edhe pse tabelat digjitale janë objekt kryesor, pjesë të tjera (rrjeti, switch, router) janë esenciale për funksionimin e plotë të sistemit. Metodologjia është e standardizuar dhe e qartë për të gjithë ofertuesit, duke eliminuar mundësinë e vlerësimit subjektiv. Nuk ka evidencë që ndonjë operator penalizohet ose favorizohet për shkak të metodologjisë.

Ekspertit shqyrtues mendon Pretendimi i OE-së se metodologjia e peshimit të çmimeve është e padrejtë dhe diskriminuese është i pabazuar dhe se Forma aktuale e vlerësimit për njësi është ligjore, transparente dhe proporcionale, duke marrë parasysh natyrën e projektit dhe nevojën për fleksibilitet në implementim. Pra rishikim ose anulim i procedurës nuk është i nevojshëm, pasi metodologjia aktuale lejon konkurrencë të drejtë dhe zgjedhje të ofertës më të favorshme për Autoritetin. Dhe kjo bazohet sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,,dhe si përfundim

Eksperti Shqyrtues Mendon se pretendim i gjendet i PA BAZUAR

Pretendimi i 4 OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë

Pretendimi i 4 OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë Pretendimi 4 Produktet e rrjetit të mbyllura me autorizime Duke shqyrtuar specifikimin teknik të referuar në Aneksin 1 (përshkrimi i çmimeve), vërejmë se përdisa produkte të Tabelës B (Nr. 35, 37, 38, 39, 40 dhe 41) kërkohet autorizim nga prodhuesi ose distributori. Konkretisht produktet janë:

35: Firewall Router

37: WiFi 7 Access Point (AP)

38: Switch 28-port L2+ PoE me 10G uplinks

39: Switch 52-port L2+ PoE me 10G uplinks

40: Router

41: Hardware Controller Bazuar në këto kërkesa specifike dhe kriterin e autorizimeve konstatohet se kemi shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP): Neni 28 (Specifikimet teknike) – specifikimet e mbyllura kufizojnë konkurrencën;

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – operatorët e tjerë nuk mund të ofrojnë produktet e tyre; Neni 52 (Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës) – kriteret për autorizim nuk janë të qarta dhe të komunikueshme; Neni 69 (Aftësia teknike dhe/ose profesionale) – kufizimi pengon ofertues me aftësi të barabartë. Vërejmë se këto produkte janë specifikuar me modele të caktuara dhe kërkojnë autorizime që vetëm disa operatorë ekonomik mund t'i sigurojnë. Si pasojë, kjo mbyll mundësinë për ofertim nga operatorë të tjerë dhe kufizon konkurrencën në mënyrë të papërshtatshme, duke krijuar një situatë selektive që nuk është në përputhje me LPP-në. Sipas Ligjit për Prokurimin Publik, specifikimet teknike duhet të jenë të hapura, transparente dhe të barabarta për të gjithë operatorët ekonomik, në mënyrë që të mundësohet ofertim konkurrues dhe i lirë. Aktualisht, kërkesat për autorizim për produktet e sipërpërmendura kanë krijuar barriera që pengojnë ofertuesit e tjerë të ofrojnë produktet e tyre. Përgjigja e Autoritetit, sipas së cilës këto specifikime mund të ofrohen edhe nga brendet e tjera, është një e pavërtetë e madhe. Në realitet, kërkesat specifike nuk plotësohen nga asnjë brand tjetër përveç atyre të precizuara, me ose pa interes. Kjo situatë nuk i bën mirë Autoritetit dhe nuk garanton transparencë apo konkurrencë të lirë për publikun. Ekspertët e OSHP-së mund ta verifikojnë këtë lehtësisht me një shfletim të thjeshtë në internet, dhe do të konstatojnë se kërkesat e Autoritetit janë mbyllëse dhe selektive. Ne si operatorë kërkojmë: Heqjen e kërkesave për autorizim specifik për produktet e Tabelës B; Sigurimin që specifikimet teknike të jenë të hapura dhe të mundësojnë ofertim nga të gjithë operatorët ekonomik; Në vend të autorizimeve, të kërkohet garanci për produktet e ofruara, në mënyrë që Autoriteti të mbetet i sigurt për cilësinë dhe përputhshmërinë e produkteve. Aktualisht, produktet e kërkuara janë të mbyllura me autorizim, janë vendosur me sasi 1 copë, dhe nuk specifikohet sasia reale që duhet furnizuar. Shumë produkte nuk kanë ekuivalencë në specifikim; për shembull, Firewall Router (produkt nr. 35) përjashton të gjitha brand-et tjera, ndërsa për Access Point (produkt nr. 37), Switch 28-port (produkt nr. 38), Switch 52-port (produkt nr. 39), Router (produkt nr. 40) dhe Hardware Controller (produkt nr. 41) kërkohet autorizim specifik nga prodhuesi. Përgjigja e Autoritetit, se autorizimi është i nevojshëm për të “larguar tregun e zi”, nuk mbështetet në ligj dhe nuk mund të justifikojë mbylljen e konkurrencës tek një operator i vetëm. Autoriteti ose duhet të liroj specifikimet për të mundësuar ofertim nga shumë operatorë, ose duhet të heqë kërkesën për autorizim dhe të lejojë ofertim të lirë. Duke pasur parasysh vlerën e lartë të projektit dhe situatën aktuale, lehtësimi i kriterëve për autorizim është i domosdoshëm për të mundësuar ofertim konkurrues, barazi dhe transparencë, duke garantuar që Autoriteti të marrë ofertën më cilësore dhe më të favorshme financiarisht. Kërkojmë nga OSHP që të vlerësojë këtë ankesë dhe të rekomandojë Autoritetin që të largojë autorizimet e panevojshme, të lirojë specifikimet teknike dhe të sigurojë një proces transparent, të drejtë dhe konkurrues për të gjithë operatorët ekonomik.

Përgjigje në Pretendimin 4 të OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë

AK ka kërkuar që OE të jenë të autorizuar nga prodhuesi (MAF) ose distributori i autorizuar (DAF) për territorin e Kosovës për produktet e cekura në Aneksin 1. Eksperti shqyrtues mendon se Kjo kërkesë ka bazë në Ligjin për Prokurimin Publik duke garantuar siguri, cilësi dhe përputhshmëri të produkteve kritike për projektin.

Eksperti shqyrtues thekson se Pretendimi i OE-së për mbyllje konkurrencës OE pretendon se kërkesa për autorizim kufizon konkurrencën dhe favorizon disa operatorë të caktuar. Në ankesën e tyre në OSHP, ata kërkojnë heqjen e autorizimeve specifike dhe lehtësimin e kriterëve për të mundësuar ofertim më të gjerë. Ata argumentojnë se produktet (Firewall Router, Access Point, Switch, Router, Hardware Controller) nuk kanë ekuivalencë dhe nuk mund të plotësohen nga brende të tjera.

Mendimi ekspertit shqyrtues është se Autorizimi i OE-së është i ligjshëm dhe i arsyeshëm, sepse: Siguron që produktet e ofruara janë origjinale dhe përputhen me specifikimet teknike të AK-së. Parandalon përdorimin e produkteve të pa autorizuar ose të tregut të zi, gjë që është kritike për një projekt publik të madh. Kjo kërkesë është në përputhje me praktikën e mira vendore dhe ndërkombëtare, dhe nuk cënon parimin e barazisë, sepse çdo Operator Ekonomik i autorizuar ka të njëjtat të drejta ofertimi.

Operatoret Ekonomik duhet 3. OE duhet të ketë edhe një Deklaratë për përmushjen e specifikave teknike të kërkuar në Aneksin Kataloag për artikujtë e kërkuar në Aneksin 1, original nga prodhuesi. për të demonstruar përputhshmërinë e pajisjeve, çka është standard i zakonshëm në procedurat e prokurimit.

Eksperti shqyrtues mendon se Përkundër pretendimit të OE-së, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje dhe sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe ka garantuar transparencë dhe standard të barabartë për të gjithë OE-të e autorizuar. Kërkesa e AK-së nuk është masë diskriminuese, por siguron performancën, sigurinë dhe funksionalitetin e projektit, duke mbrojtur interesin publik.

Kërkesat për autorizim nuk janë të dedikuara për një brand të vetëm, por për pajisje që plotësojnë të gjitha parametrat e kërkuar, dhe çdo OE i autorizuar mund të konkurrojë në kushte të barabarta.

Eksperti mendon se Pretendimi i OE-së për mbyllje të konkurrencës është i pa bazuar. AK ka vepruar ligjërisht dhe arsyeshëm, duke vendosur kriterë të qarta që: Sigurojnë cilësi dhe përputhshmëri të produkteve. Parandalojnë përdorimin e produkteve të paautorizuara/tregut të zi. Ruajnë transparencën dhe barazinë midis operatorëve të autorizuar dhe si përfundim.

Eksperti Shqyrtues Mendon se pretendim 4 i gjendet i PA BAZUAR

Pretendimi i 4 OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë

Pretendimi 4 Tabelat e Mençura – specifikim për vetëm një Brand dhe autorizim Duke shqyrtuar specifikimin teknik të projektit “Furnizim me Tabela Digjitale”, vërejmë se për Tabelën C (pozicionet 71–96), e cila përbën vetëm 20% të vlerës totale të ofertës, kërkohet një specifikim i veçantë që lidhet direkt me një prodhues të vetëm. Ne mund të ofrojmë produktin e kërkuar, por për shkak të kërkesës për autorizim nga prodhuesi, nuk mund të ofertojmë këtë produkt. Kjo krijon një barrierë artificiale që kufizon konkurrencën dhe pengon ofertim të lirë, duke vendosur operatorët e tjerë në një pozitë të pabarabartë.

Rikapitulimi

1.00 A - Gjithsej (1 - 61) : 50%

2.00 B - Gjithsej (62 - 70) : 30%

3.00 C - Gjithsej (71 - 96) : 20%

Pesha e projektit është e shpërndarë si më poshtë:

A – Gjithsej (1–61): 50%

B – Gjithsej (62–70): 30%

C – Gjithsej (71–96 – Tabela Digjitale): 20%

Pra, aktiviteti kryesor i prokurimit, blerja e Tabelave Digjitale, është nënvlerësuar dhe i kushtëzuar nga një model specifik, ndërsa pjesa tjetër e projektit favorizon produkte të tjera, duke krijuar një përçarje të paarsyeshme të peshës dhe prioritetit të prokurimit. Kërkesa aktuale për autorizim shkel qartë nenet e LPP-së: Neni 28 (Specifikimet teknike) – specifikim i mbyllur për një model të vetëm;

Neni 7 (Barazia në trajtim / jo-diskriminimi) – kufizon ofertim të lirë dhe konkurrencë të ndershme; Neni 65 (Provueshmëria e kandidatëve / tenderuesve) – operatorët nuk mund të sigurojnë autorizim, duke shkelur mundësinë për ofertim të barabartë. Problemet kryesore janë: Operatorët ekonomik nuk mund të marrin autorizim direkt nga prodhuesi; Përdorimi i distributorit nuk është zgjidhje reale, pasi prodhuesi nuk ka distributor të autorizuar në rajonin tonë; Specifikimi teknik lidhet direkt me një model të vetëm, duke penguar përdorimin e produkteve alternative që përmbushin të njëjtat kërkesa; Përgjigjja e Autoritetit, se specifikimet mund të plotësohen nga brendet e tjera, është plotësisht e pavërtetë, pasi asnjë brand tjetër nuk përmbush kërkesat e funksionaliteteve kritike si monitorim nga larg, mesazhe emergjente, bllokim, restart dhe factory reset. Ekspertët mund ta verifikojnë këtë lehtësisht me një shfletim në internet. Kerkojme nga Ekspertet dhe Paneli që të rekomandoj autoritetin që të heqë kërkesën për autorizim he të lejojë ofertim me garanci nga prodhuesi ose distributori. Të rishikojë specifikimet teknike në mënyrë që të mundësohet ofertim nga produktet digjitale alternative që përmbushin funksionalitetin e kërkuar

Bazuar në analizën e mësipërme, vetëm SMART Technologies me SMART Remote Management plotëson të gjitha kërkesat e specifikimeve të tabelave të mençura, duke përfshirë monitorim nga larg, menaxhim softuerik, politika përdorimi, mesazhe emergjente, bllokim, restart, dhe factory reset. Brendet e tjera, si Promethean, BenQ dhe Clevertouch, ofrojnë vetëm pjesë të funksionaliteteve, por nuk plotësojnë kërkesat në mënyrë të plotë dhe të integruar, veçanërisht për komandat kritike dhe

dërgimin e mesazheve emergjente. Kjo tregon qartë se kërkesa i dedikohet vetëm SMART dhe asnjë tjetër brand nuk e plotëson komplet këtë paketë veçorish. KERKOJME: Kerkojme nga OSHP, që të urdheroj AK-ne për përmirësimin e kritereve të dosjes. Gjithashtu t'i erkoj AK-s ndarjen në LOTE

Përgjigje në Pretendimin 4 OE “" KOSPROD " SH.P.K.”- Prishtinë

Analizë e pretendimit për SMART Board (Tabelat Digjitale) Kërkesa e AK-së 8.OE duhetë që të dëshmojë se SMART BOARD, janë BRAND i Njohurë ndërkombëtar dhe kanë softuer që përdoret -

ndërkombtarishtë për ligherime. Dhe që i njeiti softuer ka mundësi të instalohet edhe ne Laptop apo PC. Në mënyrë që Profesorët të kenë më të lehtë të ndërveprojnë në ligjeratat e tyre në mes të PC dhe Tabeles së Mencurë. dhe se AK ka kërkuar që operatorët ekonomikë të jenë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për Kosovën, për SMART Board (Tabela Digjitale), duke kërkuar gjithashtu që OE të ofrojë katalog/datasheet për produktin e ofruar. Qëllimi i kësaj kërkesë është garancia e cilësisë dhe përputhshmërisë së softuerit dhe pajisjes, si dhe parandalimi i përdorimit të produkteve të paautorizuara ose të tregut të zi, duke mbrojtur interesin publik dhe se AK NUK KA CEKUR QE smart board te jen vetëm nga një prodhues dhe ka len alternativ duke theksuar nje brend .

Pretendimi i OE-së ku argumenton se kjo kërkesë kufizon konkurrencën dhe favorizon vetëm SMART Technologies. Operatori Ekonomik kërkonë që të hiqet kërkesa për autorizim. Të lejohet ofertim nga produkte alternative që plotësojnë funksionalitetin e kërkuar. Operatori Ekonomik thekson se brendet e tjera nuk kanë autorizime dhe nuk plotësojnë të gjitha veçoritë kritike (monitorim nga larg, mesazhe emergjente, bllokim, restart, factory reset).

Mendimi ekspertit shqyrtues është se siç e thamë edhe ne pretendimin e me përparshëm është se Autorizimi është i ligjshëm dhe i arsyeshëm për produktet kritike të SMART Board, sepse: Siguron që produktet dhe softueri janë origjinale dhe funksionale sipas standardeve ndërkombëtare. Parandalon përdorimin e produkteve të tregut të zi, që mund të krijojë rrezik për mësimdhënie dhe integritetin e pajisjeve. Garanton që softueri mund të instalohet në laptop/PC dhe të funksionojë në mënyrë të integruar, siç kërkohet për ligjëratat dhe aktivitetet pedagogjike.

Eksperti shqyrtues mendon se Pretendimi i OE-së për mbyllje të konkurrencës është i pa bazuar, sepse: Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me LPP dhe praktikat më të mira ndërkombëtare kur ka kërkuar Brend dhe jo një produkte te specifikuar. Eksperti shqyrtues mendon Autorizimi nuk kufizon konkurrencën për OE-të që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

Eksperti thekson Pretendimi i OE-së nuk ka bazë ligjore, sepse AUTORITETI Kontraktues ka garantuar që çdo OE i autorizuar mund të ofertojë dhe se Autorizimi është i nevojshëm dhe i ligjshëm për të mbrojtur sigurinë, funksionalitetin dhe interesin publik dhe se AK nuk ka kërkuar vetëm një lloji Artikulli por ka len Alternativa duke përdorur fjalën brend (kjo është e ngjashme “ose ekuivalente” apo “ose të ngjashme ndërkombëtare”).Dhe kjo bazohet sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lagjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,dhe si përfundim.

Eksperti Shqyrtues Mendon se pretendim 4 i gjendet i PA BAZUAR

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0929 i dorëzuar me dt. 06.10.2025, i hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, nuk përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta

shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore, për shkak se eksperti shqyrtues profesional nuk ka kërkuar ndihmën e ekspertit shqyrtues teknik në përgjigje të pretendimeve ankimore që kanë pasur të bëjnë me çështje teknike të teknologjisë informative.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik. Pikërisht për këtë Paneli Shqyrtues kërkoj angazhimin e një eksperti shqyrtues teknik nga teknologjia informative për të bërë një raport të ekspertizës dhe tu jepet përgjigje pretendimeve ankimore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues teknik është i hartuar me dt. 03.11.2025, me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Konstatimet në raportin e ekspertit të datës 03.11.2025 mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i mbështet përgjigjet/konstatimet e dhëna në raportin e hartuar nga eksperti shqyrtues teknik, raport ky i cili u është dërguar të gjitha palëve.

Paneli Shqyrtues në kuptim të nenit 7 të LPP dhe të gjithë paragrafëve tjerë të kësaj dispozite, autoritetet kontraktuese janë të obliguara të veprojnë dhe ti trajtojnë të gjithë OE në mënyrë të barabartë, duke mos vendosur kërkesa të cila diskriminojnë apo favorizojnë të tjerët, e posaçërisht duhet të citohet paragrafi 6 i këtij neni, i cili citon: "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i

zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse".

Andaj, Paneli Shqyrtues do të ndalet vetëm në pretendime ankimore për të cilat ekspert shqyrtues ka konstatuar se të njëjtat duhet të përmirësohen dhe të cilat përgjigje kanë gjetur mbështetje edhe nga ana e këtij Paneli. Kështu që autoriteti kontraktues duhet të fokuset dhe ti bëjë përmirësimet në Dosje të Tenderit vetëm në këto pika:

Fillimisht, obligohet AK që të bëjë rishikimin e peshës së kategorive në përputhje me dispozitat e RrPP sepse peshimi i përcaktuar nga AK për këtë aktivitet nuk është në përputhje me rëndësinë reale të kategorive të përfshira. Konkretisht, në Pjesën (Tabelën) A janë përfshirë kabllot, Rack kabineti, kanalet plastike dhe aksesoret, të cilët kanë marrë peshë 50%, ndërsa në Pjesën (Tabelën) C, ku përfshihet Tabela Digjitale 75", është përcaktuar peshë vetëm 20%. Ky vlerësim bie ndesh me rëndësinë e komponentëve, siç përcaktohet në nenin e sipërpërmendur, pasi analiza e tregut tregon qartë se Tabela Digjitale 75" ka koston dhe natyrshëm edhe rëndësinë shumë më të lartë sesa një set i pozicioneve të përfshira në Tabelën A. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Së dyti të bëhet rishikimi i specifikimeve teknike nga ana e AK në përputhje me LPP dhe RrPP specifikimet teknike janë të përcaktuara në mënyrë që i referohen pajisjëve të markave specifike dhe nuk janë përpiluar si përgjigje për nevojat reale të rrjeteve të shkollave, përkatësisht të nevojave të AK-së. Shumë prej parametrave janë të ekzagjeruar dhe krijojnë kufizim të panevojshëm të konkurrencës. Një formulim më neutral, me specifikime të arsyeshme për performancë dhe siguri, bazuar në nevoja, do të mundësonte pjesëmarrje më të gjerë të OE-ve, çmime më të favorshme dhe zbatim më efikas të aktivitetit në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit të 16 përcaktuara në LPP. Për rrjedhojë, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Po ashtu AK të rishikojë dhe të riformulojë specifikimet teknike në mënyrë neutrale dhe të hapur, duke përcaktuar parametra dhe funksione të cilat argumentohet se janë të nevojshme për pajisje të tilla. Sepse specifikimet teknike për Tabela Digjitale janë formuluar në mënyrë që praktikisht favorizojnë vetëm një prodhues, konkretisht SMART Technologies. Në specifikim janë përfshirë terma tregtarë si "“SilkTouch” dhe funksione që lidhen drejtpërdrejt me platformën SMART Remote Management, të cilat nuk plotësohen nga produktet e brendeve të tjera. Kërkesa të tilla si dërgimi i mesazheve emergjente, bllokimi, zhbllokimi, restartimi dhe rivendosja nga distanca përmes cloud janë specifike për këtë brand dhe nuk ofrohen nga prodhuesit e tjerë të tabelave interaktive. Një pjesë e parametrave teknikë është gjithashtu e pajustificueshme. P.sh. kërkesa që një që të ketë "frame rate ≥ 125 Hz" dhe njëkohësisht "refresh rate 60 Hz", nuk është reale për këtë kategori pajisjesh dhe përjashton shumicën e brendeve të tjera. Po ashtu, përfshirja e një game shumë të gjerë funksionesh softuerike: si simulime 3D, kuize interaktive, autodraw pen dhe sinkronizim me platforma cloud, e bën praktikisht të mundur vetëm ofertimin e një prodhuesi që i ofron të gjitha këto në një sistem të integruar. Në këtë formë, specifikimi teknik është i mbyllur dhe nuk lejon konkurrencë të lirë, duke përjashtuar OE-

të që mund të ofrojnë produkte ekuivalente. Një qasje e tillë bie ndesh me nenin 28 të LPP-së, i cili kërkon që specifikimet të jenë neutrale dhe të bazuara në performancë, si dhe me nenin 7, që garanton barazinë dhe trajtimin e drejtë të gjithë operatorëve ekonomikë. Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK nuk ka arsyetuar nevojën për këto specifikime, por vetëm është thirrur në besimin që i është falur njësisë së kërkuese për hartimin e specifikimeve, pa dhënë arsyetimin e nevojës për specifikime/funksione të cilat janë kërkuar. Prandaj, rekomandohet

PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim. Andaj përfundimisht PSH ka vendosur se, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues se Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka kritere diskriminuese/kufizuese, kështu që, PSH obligon AK që të bëhen përmirësimet konform vlerësimit të këtij vendimi dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues teknik..

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që duhet të përmirësohet Dosja e tenderit/ Njoftimin për Kontratë e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “168 Paisje IT-Tabela Digjitale” me numër të prokurimit 616-25-6962-1-1-1, pasi që është vlerësuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore, ndaj të bëhen përmirësimet e DT dhe të zgjatet afati për tenderim.

Paneli Shqyrtues vlerëson se duhet përmirësuar kriteret e Dosjes tenderit/Njoftimit për Kontratë, për aktivitetin e prokurimit të lartcekur për shkak të kriterëve të cilat disa prej tyre nuk jenë në përputhje me dispozitat ligjore andaj obligohet Autoriteti Kontraktues të bëjnë përmirësimet e kriterëve të Dosjes tenderit/Njoftimit për Kontratë. Paneli shqyrtues konstaton se kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " KOSPROD " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: